



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 554 Akti

Nr. 679 Vendimi
Tiranë, më 21.6.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datat 15.5.2023, ora 10:00 dhe 19.6.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, zhvilloi seancat dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Julian Zonja, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

i. Z. Julian Zonja është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ii. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Julian Zonja i është nënshtruar procesit të

rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine (relatore).

iii. Me vendimin e datës 13.9.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pranoi kërkesën e komisionerit Olsi Komici për përjashtimin e tij nga trupi gjykues për arsye të deklarimit të konfliktit të interesave me subjektin e rivlerësimit dhe zëvendësimin e tij me komisionerin Lulzim Hamitaj.

iv. Nga Komisioni janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

v. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues komisionerin Lulzim Hamitaj dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

vi. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (a) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Julian Zonja, për të tria kriteret e rivlerësimit; (b) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (c) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (ç) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

vii. Në datën 26.4.2023, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

viii. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore në datën 15.5.2023, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, Tiranë.

I. SEANCA DËGJIMORE

ix. Në datën 15.5.2023, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhgueses ndërkombëtare, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

a) Pas përfundimit të seancës dhe pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit, trupi gjykues, përpara diskutimeve finale të trupit gjykues mbi vendimmarrjen, vendosi të shtyjë diskutimet përfundimtare mbi vendimmarrjen dhe shpalljen e vendimit për të kryer verifikimin e dy procedimeve penale të referuara në një artikull të publikuar në media, për të vlerësuar nëse kishte në to të dhëna për të riçelur hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit.

b) Pas verifikimit të kryer me vendimin e datës 9.6.2016, trupi gjykues vendosi të riçelë hetimin administrativ dhe të kërkojë shpjegime nga subjekti në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2017.

c) Në datën 12.6.2023, Komisioni njoftoi subjektin mbi rezultatet shpesh të hetimit administrativ në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2017, duke kërkuar shpjegimet e tij lidhur me këtë procedim deri në datën 15.6.2023. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime shpesh brenda afatit të caktuar nga Komisioni.

ç) Në datën 19.6.2023, ora 10:00, u zhvillua seanca e dytë dëgjimore në prani të subjektit dhe vëzhgueses ndërkombëtare, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 21.6.2023, ora 9:30.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

x. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

xi. Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimet nr. 2 dhe nr. 17, të vitit 2017, të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore, për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

xii. Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaramat periodike/vjetore dhe në deklaramtën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkresore të administruara dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, për pasuritë e subjektit dhe të personave të lidhur me të, kanë rezultuar si vijon:

1. Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 63.8 m², me vlerë 55.000 euro, në *, Tiranë**

1/a. Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

1.1 Në deklaramtën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë apartament të blerë me kredi të marrë në BKT, në shumën 6.200.000 lekë, si dhe nga të ardhurat në shumën rreth 1.230.000 lekë.

1.2 Në deklaramin e interesave privatë periodikë për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit, në ndryshim të interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ka deklaruar: “*Apartament 1+1 ***, Tiranë, me sip. 63.8 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 9.9 m², i blerë me kredi nga BKT-ja. Çmimi i apartamentit 55.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. ***kol., datë 7.3.2011*”.

1.3 Në detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, pjesë të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në BKT, në shumën 6.200.000 lekë, me afat shlyerje 20 vjet, për blerje apartamenti 1+1, në ***, Tiranë, me sipërfaqe 63.8 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 9.9 m².

1.4 ASHK Drejtoria Vendore Rurale 1 konfirmon apartament të regjistruar në emër të subjektit me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Tiranë, me sip. 63.8 m².

1.5 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në bazë të kontratës së shitblerjes me rezervë të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2011, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse z. Julian Zonja, është kryer shitja e pasurisë së paluajtshme e llojit apartament me sip. 63.8 m², e ndodhur në ***, Tiranë, kundrejt çmimit të shitblerjes 55.275 euro.

1.6 Në kontratë është parashikuar se kalimi i fondeve do të bëhet në llogarinë bankare të shitësit, ndërsa kalimi i pronësisë në favor të palës blerëse do të bëhet pasi të plotësohet rezerva ligjore, pra kur pala blerëse të shlyejë çmimin e plotë të shitblerjes së përcaktuar në kontratë.

1.6.1 Referuar dokumentacionit bankar rezulton se në datën 22.4.2011, është transferuar nga llogaria në euro në emër të subjektit në BKT, shuma 54.079 euro, me përshkrimin “Julian Zonja sa kalon për “****” sh.p.k. për likuidimin e blerjes së apartamentit sipas kontratës datë 7.2.2011, nr. *** rep., nr. *** kol.”.

1.6.2 Me deklaratën noteriale të datës 22.4.2011, deklaruesi, shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori P. B., ka deklaruar se: “Në datën 7.3.2011 kam lidhur një kontratë shitjeje me rezervë të pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., me palë blerëse Julian Zonja, jam likuiduar plotësisht me z. Julian Zonja dhe nuk kam asnjë pretendim në lidhje me pronën e përshkruar në këtë kontratë...”.

1.7 FSHU-ja ka konfirmuar se me gjeneralitetet Julian Zonja, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent në instancën e Tiranës. Sipas informacionit mbi abonentin, data e vendosjes së matësit është 14.1.2015 dhe data e lëshimit të kontratës 14.1.2009. Komisioni hetoi duke i kërkuar informacion të detajuar FSHU-së në lidhje me faturimet e kësaj kontrate nga data e hapjes së saj dhe rezultoi se për periudhën tetor 2009 – mars 2011 faturimet për këtë kontratë kanë qenë në vlerën e tarifës së mirëmbajtjes, pa konsum energjie.

1.8 UKT-ja ka konfirmuar se në emër të subjektit Julian Zonja rezulton një kontratë me adresë rruga “****”, Tiranë, hapur me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2011, lidhur midis subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k.

Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe mundësia financiare

Komisioni analizoi burimin e të ardhurave të deklaruara në deklaratën *Vetting*, konkretisht:

Të ardhurat në shumën rreth 1.230.000 lekë

1.9 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një ndër burimet për blerjen e apartamentit edhe të ardhurat në shumën rreth 1.230.000 lekë.

1.10 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 5.2.2016, subjekti ka deklaruar se: “...Në lidhje me diferencën e paguar nga ana ime, sqaroj se ka si burim kursimet e mia dhe të bashkëshortes, të cilat janë kursyer për qëllim blerjen e apartamentit. Kjo shumë është depozituar në BKT dhe së bashku me kredinë e marrë po në BKT është bërë pagesa e blerjes së apartamentit”.

1.11 Referuar të dhënave nga BKT-ja në llogarinë në lekë në emër të subjektit në këtë bankë, në datën 28.3.2011 është depozituar *cash* shuma 430.000 lekë, ndërsa në datën 29.3.2011 është depozituar *cash* edhe shuma 800.000 lekë.

1.12 Gjithashtu, në llogarinë në dollarë në emër të tij, subjekti në datën 28.3.2011 ka depozituar *cash* shumën 1.524 USD dhe në datën 22.4.2011 e ka konvertuar në euro brenda bankës

shumën në kundërvlerë 1.043 euro. Ndërsa në llogarinë në euro në emër të tij, në të njëjtën bankë, në datën 28.3.2011, ka depozituar *cash* shumën 1.400 euro.

1.13 Nga hetimi rezulton se subjekti dhe bashkëshortja kanë lidhur martesë në datën 10.5.2010.

1.14 Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndryshime të interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ndërsa në të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe private ka deklaruar të ardhurat e tij dhe të ardhura të përfituara nga bashkëshortja.

1.14.1 Personi i lidhur/bashkëshortja ka deklaruar depozita në Intesa Sanpaolo Bank në shumat 400.000 lekë, 1.500 USD dhe 1.350 euro, me burim të ardhurat personale dhe nga familja.

1.15 Referuar të dhënave bankare, rezulton se bashkëshortja e subjektit ka pasur llogari depozitat e deklaruara, të cilat janë krijuar në vitin 2009. Në datën 28.3.2011, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka tërhequr nga llogaritë depozitë në emër të saj në Intesa Sanpaolo Bank shumat 428.800 lekë, 1.404,67 euro dhe 1.524 USD. Shumat e tërhequra në datën 28.3.2011 nga Intesa Sanpaolo Bank janë depozituar në të njëjtën ditë në llogari të subjektit në BKT.

1.16 Në lidhje me shumën 800.000 lekë të depozituar *cash* në BKT, në datën 29.3.2011, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar ndër të tjera se: *“Kjo shumë buron nga kursimet e realizuara nga pagat gjatë vitit 2010 deri në mars të vitit 2011, me qëllim blerjen e apartamentit. Së bashku me bashkëshorten dëshironim të blinim një apartament dhe këtë shumë kemi filluar ta kursejmë gjatë vitit 2010 dhe mendimi ishte që në fund të vitit do të kishim mbyllur blerjen e shtëpisë dhe nuk do të kishim gjendje shumën, megjithatë në fund të vitit 2010 kjo shumë nuk mendohej të ishte 800.000 lekë, por më e vogël, por duke qenë se transaksionet për shtëpinë nuk u realizuan dhe vazhduan në janar, shkurt, derisa u përfunduan në mars 2011 me depozitimin e tyre në BKT...”*

1.17 Komisioni vlerësoi deklarin periodik vjetor të vitit 2010, ku subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar kursime të krijuara gjatë këtij viti në formën e likuiditeteve *cash* në banesë, gjendje në datën 31.12.2010.

1.18 Mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe deklarinimet e subjektit të rivlerësimit, u krye analiza financiare për periudhën 1.1.2011 – 29.3.2011, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e shumës 1.230.000 lekë, të depozituar *cash* në llogarinë bankare në lekë, në emër të subjektit, në BKT dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për këtë periudhë.

1.19 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për periudhën 1.1.2011 – 29.3.2011 rezultonin me një bilanc negativ të ardhurash në shumën -463.107 lekë.

1.20 Sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit për të provuar burimin e të ardhurave për krijimin e shumës 800.000 lekë të depozituar *cash* nga subjekti në BKT, në datën 29.3.2011.

1/b. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.21 Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, deklaroi se: *“Viti 2010 ishte viti që kishim menduar të gjenim një apartament dhe filluam të kursejmë nga të ardhurat para se të fillonin procedurat e kredisë së butë nga BKT-ja, deri në datën e depozitimit të kësaj shume në BKT në datën 29.3.2011. Është e vërtetë se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 nuk janë*

deklaruar këto kursime të krijuara gjatë këtij viti si likuiditet. Ky është thjesht një gabim i paqëllimshëm nga ana jonë. Madje, deklarata e pasurisë është plotësuar në të njëjtën kohë që unë po bëja transaksionet e banesës ditët e fundit të muajit mars, prandaj dhe duke qenë se ishin lekë për shtëpinë është një harresë apo ngatërresë në ato momente, duke pasur parasysh distancën relativisht të afërt nga momenti i fundit të vitit 2010, deri në përdorimin e këtyre kursimeve për financimin e blerjes së apartamentit. Në analizën financiare që ka bërë Komisioni për periudhën 1.1.2011 – 29.3.2011, për të verifikuar mundësinë e kursimit të shumës 800.000 lekë, janë llogaritur shpenzime për qira në shumën 60.000 lekë, pra 3 muaj, për të cilën në pyetësin nr. 1 kam deklaruar se kam banuar deri në fillim të janarit 2011. Gjithashtu, në pasqyrën që i bashkëlidhet shpjegimeve të analizës paraprahe të treguesve financiarë të rezultateve të hetimit administrativ, janë llogaritur saktësisht korrik-dhjetor 2010 shpenzime për qira në shumën 120.000 lekë, ndërsa për vitin 2011 janë llogaritur 4 muaj qira në shumën 80.000 lekë. Nga janari i vitit 2011 nuk kam banuar me qira, jemi kthyer te shtëpia e prindërve derisa kemi marrë apartamentin. Dua të shtoj se nga analiza e vetë Komisionit ne kemi arritur që për tre muaj të kursejmë rreth 400.000 lekë (pasi minusi është -463.107 lekë), kështu që, sikur të merren vetëm 3 muaj nga viti 2010, del mundësia për të kursyer gjysmën tjetër të shumës 800.000 lekë. Gjithashtu, në pasqyrën e analizës financiare Komisioni më ka nxjerrë në çdo vit me një balancë pozitive për të kursyer dhe të konsiderueshme me burim vetëm të ardhurat tona, konkretisht vetëm në vitin 2010 kjo balancë del në shumën 1.149.802 lekë, si dhe fakti që rezultati pozitiv i analizës financiare të vitit 2010 dhe të çdo viti vjen si rrjedhojë e ekzistencës së burimeve të ligjshme të të ardhurave të mia dhe të bashkëshortes, të cilat janë deklaruar rregullisht, në mënyrë të plotë dhe të saktë në momentin e krijimit të tyre”.

1/c. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.22 Trupi gjykues i Komisionit, pasi administroi provat, dëgjoi shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, duke iu referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe atyre periodike, si dhe në deklaratimet e subjektit mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ.

1.23 Trupi gjykues i Komisionit arsyeton se detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim lidhur me deklarin e çdo pasurie, përfshirë edhe likuiditetet *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

1.24 Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se kursimet e pretenduara nga subjekti, të cilat nuk janë deklaruar në DPV-në e vitit 2010, nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare.

1.24.1 Pretendimi mbi marrjen në konsideratë të kursimeve të padeklaruara në deklarin periodik përkatës është një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003, të ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti për të deklaruar çdo shtesë e pakësim të pasurisë në çdo formë që ajo ndodh përgjatë një viti periodik.

1.25 Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, vlerëson se në përfundim të analizës financiare të kryer për periudhën 1.1.2011 – 29.3.2011, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, arriti në përfundimin se me të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar

detyrimet tatimore sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk ka pasur mundësi për të përballuar shpenzimet jetike dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, si dhe për krijimin e shumës 1.230.000 lekë, duke rezultuar me bilanc negativ total në shumën -463.107 lekë.

1.26 Trupi gjykues arsyeton se mungesa e likuiditetit për vitin financiar 2011, në shumën -463.107 lekë, nuk është në masën që ndaj subjektit të aplikohet masa e shkarkimit nga detyra.

Kredi në shumën 6.200.000 lekë në BKT

1.27 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “...Kredi për blerje apartamenti banimi me sip. 63.8 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 9.9 m² në BKT, në shumën 6.2 milionë lekë, me afat 20 vjet, gjendja e mbetur në datën 24.1.2017, në shumën 3.947.600 lekë”.

1.28 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kredinë e marrë në BKT në shumën 6.200.000 lekë, me afat shlyerjeje 20 vjet, me interes 4% dhe pjesa tjetër e financuar nga shteti për blerje apartamenti 1+1 në ***.

1.29 Referuar të dhënave nga BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 26.8.2020, rezulton se:

- Me kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 13.4.2011, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kredimarrësit, dhe bashkëshortja, në cilësinë e dorëzanësit, kanë përfituar nga BKT-ja kredinë me vlerë 1.200.000 lekë. Qëllimi i kësaj kredie, referuar aneksit, është *për blerje apartamenti*, ndërsa për sigurimin e kredisë është përdorur apartamenti me sip. 63.8 m², regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

- Me kontratën e kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2011, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kredimarrësit, dhe bashkëshortja, në cilësinë e dorëzanësit, kanë përfituar nga BKT-ja kredinë e butë në vlerën 5.000.000 lekë.

Lidhur me mënyrën e përfitimit të kredisë lehtësuese në shumën 5.000.000 lekë

1.30 Komisioni hetoi lidhur me kushtet e përfitimit dhe plotësimin e kriterëve ligjore të subjektit për përfitimin e kësaj kredie lehtësuese për banesë. Referuar kontratës së kredisë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2011, kredia është përfituar nga subjekti sipas VKM-së Nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, i ndryshuar.

1.31 Enti Kombëtar i Banesave informoi Komisionin se bazuar në pikën 8 të VKM-së Nr. 600/2007, z. Julian Zonja ka dorëzuar pranë institucionit ku ishte punësuar kërkesën për trajtim me strehim, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, në bazë të të cilit komisioni i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme përzgjedhi z. Julian Zonja si përfitues të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti.

1.32 Prokuroria e Përgjithshme ka dorëzuar dokumentacionin e pjesshëm dhe mungesat u plotësuan dorazi nga z. Julian Zonja pranë EKB-së, pasi në mbështetje dhe zbatim të udhëzimit nr. *** “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi lehtësuese nga shteti”, i ndryshuar, roli i Entit Kombëtar të Banesave është subvencionimi i interesave të kredisë.

1.33 Dokumentacioni i dërguar nga EKB-ja ka bashkëlidhur edhe listën e prokurorëve, që përfitojnë kredi lehtësuese për strehim, dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme. Në këtë listë me numër rendor 3 ndodhet emri i subjektit Julian Zonja. Ka rezultuar nga hetimi se subjekti i

rivlerësimit Julian Zonja dhe personi i lidhur, bashkëshortja O. Z., nuk kanë pasur në pronësi të tyre banesë tjetër.

1.34 Në analizë të kërkesave të VKM-së Nr. 600, datë 12.9.2007, ka rezultuar se: subjekti në kohën e përfitimit të kredisë ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë që nga viti 2009; ka qenë i martuar me shtetasen O. Z. referuar Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe nuk ka pasur pasuri të paluajtshme në pronësi të tij apo të personit të lidhur, bashkëshortes së tij, si dhe as pasuri të luajtshme apo të drejta reale pasurore me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim, referuar rezultatit të hetimit administrativ; ka bashkëjetuar me bashkëshorten në një banesë me qira afër tregut elektrik Tiranë. Trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit i plotëson kushtet e përfitimit të kredisë sipas VKM-së Nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, duke mos konstatuar problematika në lidhje me përfitimin e kësaj kredie.

1.34.1 Në datën 22.4.2011, në llogarinë nr. *** në lekë, në emër të subjektit në BKT janë disbursuar 2 kredi, kredia e parë në shumën 1.188.000 lekë me kushte tregtare dhe kredia e dytë në shumën 4.950.000 lekë (kredi e butë).

1.35 Në datën 22.4.2011 është konvertuar brenda bankës në euro shuma e kredive të disbursuara dhe likuiditeteve të depozituara në shumën 7.316.925 lekë dhe, në të njëjtën ditë, është transferuar për llogari të shoqërisë ndërtuese shuma 54.079 euro, me përshkrimin “Për likuidimin e blerjes së apartamentit sipas kontratës datë 7.2.2011, nr. *** rep., nr. *** kol.”.

1.36 Në kontratën e shitblerjes me rezervë të datës 7.3.2011, çmimi i dakordësuar ndërmjet palëve është 55.275 euro, ndërsa nga llogaria bankare e subjektit është transferuar në datën 22.4.2011 shuma 54.079 euro. Me deklaratën noteriale datë 22.4.2011, shtetasi P. B., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” (palës shitëse), deklaroi se është likuiduar plotësisht dhe se nuk ka asnjë pretendim në lidhje me apartamentin.

Në lidhje me shlyerjen e kredisë në shumën 1.200.000 lekë

1.37 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti, në detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, ka deklaruar mbylljen e kredisë në datën 2.4.2015 në shumën 1.150.000 lekë.

1.38 Referuar të dhënave nga BKT-ja, rezulton se në datën 2.4.2015 bashkëshortja O. Z. derdh në llogarinë e kredisë së subjektit shumën 1.150.000 lekë, për mbyllje totale kredie.

1.38.1 Në lidhje me burimin e shumës së paguar, subjekti ka deklaruar (në DIPPV): “*Lekët e grumbulluara deri në fund të vitit 2014*”.

1.39 Në DIPPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: “*...Gjendje cash e grumbulluar nga kursimet dhe tërheqjet nga llogaritë, afërsisht 955.000 lekë...*”.

1.40 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “*... Në DPV-në e vitit 2014 kam deklaruar gjendjet cash në shumën 955.000 lekë (pra, kam saktësuar edhe DPV-në e vitit 2013), me burim kursime dhe tërheqjet nga llogaritë. Në këtë deklaram kam pasur parasysh edhe tërheqjet e vitit 2013 nga bashkëshortja...*”.

1.41 Sa më sipër, duket se nga subjekti dhe personi i lidhur në DIPPV-në e vitit 2013, është deklaruar pakësimi i likuiditeteve në bankë, por nuk është deklaruar destinacioni i tyre, pra edhe gjendja *cash* në datën 31.12.2013.

1.42 Pretendimi i subjektit për saktësim të DIPPV 2013 në DIPPV 2014 nuk mbështetet në dokumentacionin kohor përkatës të deklaruar në ILDKPKI, konkretisht në DPV-në e vitit 2014 nuk janë përmendur shumat e tërhequra nga llogaritë bankare në vitin 2013, por janë deklaruar vetëm kursime *cash* të vitit 2014, si dhe tërheqjet e kryera në këtë vit.

1.43 Komisioni vlerësoi që të pasqyrohej në analizën financiare shuma 955.000 lekë si kursim vetëm i vitit 2014.

Analiza financiare dhe mundësia financiare për mbylljen e kredisë tregtare në BKT

1.44 Mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni u krye analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015 – 2.4.2015, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për të paguar shumën 1.150.000 lekë, për mbyllje totale të kredisë tregtare në BKT, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë. Nga analiza financiare e kryer në Komision rezultoi për këtë periudhë financiare një bilanc pozitiv prej 160.397 lekësh.

1.45 Trupi gjykues vlerësoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë arritur të dokumentojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave për shlyerjen e pjesës së mbetur nga kredia tregtare në BKT, në datën 2.4.2015.

2. Automjet tip “**”, vit prodhimi ***, blerë në vitin 2004, në vlerën 250.000 lekë (aktualisht jashtë përdorimit)**

2.1 Në deklaratim të interesave periodikë privatë për vitin 2004, subjekti nuk ka deklaruar blerjen e këtij automjeti, por në deklaratimin e vitit 2005 ka deklaruar automjetin tip “****” në vlerën 250.000 lekë.

2.2 DPSHTRR-ja, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.8.2020, ka konfirmuar se në emër të subjektit ka qenë i regjistruar automjeti me targë ***, i cili figuron në statusin “çregjistrim i përhershëm”.

2.3 Në të gjitha deklaratimet e interesave periodikë vjetorë të vitit 2005 e në vazhdim, deri në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar të dhëna në lidhje me këtë pasuri, përfshirë edhe nxjerrjen jashtë përdorimit të saj.

2.4 Në bazë të kontratës së shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.8.2004, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi I. K. automjetin tip “****”, kundrejt shumës së paguar prej 250.000 lekësh.

2/a. Analizë e burimit të deklaruar për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

2.5 Në deklaratën *Vetting* si burim të ardhurash janë deklaruar të ardhurat nga paga.

2.6 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe deklaratimet e subjektit, kreu një analizë të treguesve financiarë për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen e këtij automjeti në datën 11.8.2004, në vlerën 250.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për periudhën 1.1.2004 – 11.8.2004, nga ku subjekti rezultoi me një bilanc pozitiv prej 172.526 lekësh. Trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit në datën 11.8.2004, në shumën 250.000 lekë.

Deklarimi i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit

3. Automjet tip “**”, vit prodhimi ***, me vlerë 10.000 euro**

3.1 Në DIPP-në e vitit 2016, bashkëshortja e subjektit, në deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur, ka deklaruar ndër të tjera: “...Automjet tip “****”, vit prodhimi ***, me targë ***. Blerë me kursimet e pagës 592.790 lekë, kredi nga banka *** në vlerën 650.000 lekë dhe teprica e grumbulluar nga këstet e paguara për kredinë tek BKT-ja, në shumën 219.100 lekë”. Tek shpenzimet e deklarueshme ka deklaruar kontratë noteriale të blerjes së këtij automjeti, konkretisht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.7.2016.

3.2 DPSHTRR-ja ka konfirmuar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka në pronësi automjetin e regjistruar me targë ***, duke dërguar dosjen e plotë të këtij automjeti.

3.3 Referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, ky automjet është blerë nga shtetasi M. K. në Gjermani për shumën 9.000 euro, si dhe janë shlyer detyrimet doganore në vlerë 258.454 lekë.

3.4 Në bazë të kontratës së shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.7.2016, personi i lidhur ka blerë nga shtetasi M. K. automjetin tip “****” me targë ***, kundrejt shumës 10.000 euro, e cila është likuiduar plotësisht.

3.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me mospërputhjet në çmimin e blerjes me kostot e ardhjes së këtij automjeti, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se: “...Lekët e zhdoganimit i kam paguar unë ...ndonëse në zhdoganim mund të jetë emri i shitësit si importues i makinës...”.

3/a. Analizë e burimit të deklaruar për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

3.6 Subjekti i rivlerësimit si në DIPPV-në e vitit 2016, ashtu edhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar 3 burime të të ardhurave për pagesën e çmimit të blerjes së automjetit tip “****”, me targë ***.

i) Kursimet e pagës në vlerën 592.790 lekë

Për periudhën nga fillimi i vitit 2016 deri në datën e blerjes së automjetit (27.7.2016), në llogarinë e pagës së subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortes) në Credins Bank është kredituar shuma 1.326.533 lekë, në formën e të ardhurave nga paga.

*ii) Kredi nga banka *** në vlerën 650.000 lekë*

Në bazë të të dhënave nga OTP Bank, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë përfituar një kredi bankare me kontratë të datës 2.3.2016, me qëllim të përcaktuar: “Për blerje makine”.

Në datën 2.3.2016, në llogarinë e përbashkët të subjektit dhe bashkëshortes në OTP Bank, është disbursuar kredia në vlerën 650.000 lekë dhe, në të njëjtën datë, është transferuar shuma prej 636.000 lekësh në favor të shtetases O. M. (bashkëshortja e subjektit) në Credins Bank.

iii) Teprica e grumbulluar nga këstet e paguara për kredinë në BKT në vlerën 219.100 lekë

Referuar informacionit nga BKT-ja, rezulton se në datën 15.3.2016 është transferuar nga llogaria në lekë në emër të subjektit shuma 219.100 lekë, me përshkrimin “Kalim fondi”, me përfitues shtetases O. M. Kjo shumë ka kaluar në llogari të znj. M. në Credins Bank.

3.7 Referuar dokumentacionit bankar/financiar të administruar në datën 31.5.2016, është tërhequr *cash* nga llogaria në emër të personit të lidhur në Credins Bank shuma 1.447.890 lekë.

3.8 Mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni u krye analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2016 – 27.7.2016, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për blerjen e automjetit tip “****”, me targë *** (në vlerën 10.000 euro + shpenzimet e zhdoganimit në shumën 258.454

lekë), si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për këtë periudhë. Nga analiza financiare e Komisionit rezultoi një balancë fondesh pozitive prej 149.325 lekësh, duke arritur në përfundimin se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit në datën 27.7.2016, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2016 – 27.7.2016.

4. Depozitë në Credins Bank, gjendje në datën 24.1.2017, në vlerën 116.562 lekë

4.1 Në deklarinimin e interesave privatë të personit të lidhur për vitin 2011, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar, ndër të tjera, edhe dy depozita pa afat në Credins Bank, me data krijimi 25.11.2011 dhe 30.12.2011, në vlerë 100.000 lekë/secila, pjesë takuese 100% dhe me burim të ardhurat nga pagat.

4.2 Në bazë të dokumentacionit të administruar nga Credins Bank, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.10.2020, rezulton se kjo llogari depozitë është krijuar në vitin 2011. Për periudhën 2011 – 2016, kjo llogari depozitë në emër të personit të lidhur ka pasur këto gjendje në fund të çdo viti:

Viti	Gjendje në datën 31 dhjetor
2011	200.155
2012	505.989
2013	17.192
2014	92.263
2015	300.558
2016	116.562

4.3 Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 rezulton në vlerën 116.562 lekë dhe ka mbetur e pandryshuar deri në dorëzimin e deklaratës *Vetting*. Komisioni ka konstatuar se përputhet deklarimi me gjendjen faktike të konfirmuar nga Credins Bank në këtë datë.

5. Analiza e treguesve financiarë

5.1 Nga analiza e përgjithshme e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2016, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, si dhe në deklarinimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, rezulton se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme nga burime të dokumentuara për blerje/krijim të pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara gjatë periudhës së deklarinimit.

6. Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

6.1 Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë.

6.2 Ai nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

6.3 Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve gjatë vitit 2011 në vlerën -463.107 lekë, për gjithë periudhën e deklarinimit, si rezultati final financiar negativ pas analizës financiare të përditësuar, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit.

6.4 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka justifikuar bindshëm pasuritë e tij në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016,

duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

7. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënat e tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin fillestar nr. *** prot., datë 31.10.2017, të deklasifikuar plotësisht¹, me konstatimin *për përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Julian J. Zonja*.

7.1 Me shkresën nr. *** prot., datë 13.4.2023, AKSIK-ja ka dërguar njoftimin për deklasifikimin pjesërisht të raportit të përditësuar për kontrollin e figurës, të përcjellë në datën 19.5.2021, i cili informon se:

7.1.1 Informacionet e ardhura nga autoritetet verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit na bëjnë me dije se për subjektin e rivlerësimit Julian Zonja disponohen të dhëna mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës. Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Julian J. Zonja, konkluzioni nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar është lënë në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ, që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

7.2 Komisioni, nga informacionet e dhëna në raportin e AKSIK-së, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke analizuar edhe dosjen penale si vijon:

7.3 Procedim penal nr. ***, datë 1.11.2016, me kallëzues N. M. kundër inspektorëve të IKM-së, Bashkia Tiranë, akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”. Nga materialet e dosjes ka rezultuar se në Komisarriatin e Policisë nr. ***, Tiranë, është regjistruar kallëzimi penal ndaj njëri-tjetrit, i shtetasve M. M. dhe H. B. Shtetasi M. M. ka banesën e vet në rrugën “****”, e cila është e pajisur me leje legalizimi. Në datën 26.10.2016, në rrugën ku ndodhet banesa, kanë shkuar inspektorët e IMT-së Bashkia Tiranë, të cilët kanë bërë punime dhe kanë filluar të prishin pjesë nga muri rrethues apo pemët që janë mbjellë brenda murit rrethues. Nga ana tjetër, shtetasi H. B., me detyrë inxhinier ndërtimi dhe drejtues punimesh i shoqërisë “****” sh.p.k., ka bërë kallëzim ndaj shtetasit M. M., për faktin se shoqëria është duke ndërtuar në ***, në bazë të lejes zhvillimore nr. ***, datë 10.10.2014, miratuar me vendimin nr. ***, datë 20.8.2014, të Bashkisë Tiranë, por shoqëria është penguar në rrethimin e kantierit, për arsye se mbi njërin nga parcelat mbi të cilën është marrë leja e ndërtimit, gjendet shtëpia e banimit e shtetasit N. M.

7.4 Në datën 7.12.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 1.11.2016”. Ky vendim është arsyetuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili arrin në konkluzionin se punonjësit e IMT-së Bashkia Tiranë nuk kanë konsumuar elemente të veprës penale “shpërdorim detyre”,

¹ Vendimi nr. ***, datë 7.7.2020, i KDZH-së.

parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Me vendimin nr. *** akti, datë 30.3.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “Shfuqizimin e vendimit për mosfillimin e hetimeve, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve për këtë çështje”. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 18.6.2018, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 30.3.2018”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur që Prokuroria në rihetimin e kësaj çështjeje duhet të verifikojë dhe të hetojë në lidhje me: (i) faktin nëse nga IMT Bashkia Tiranë është marrë apo jo një vendim për prishjen e ndërtimit; (ii) të marrë në pyetje punonjësit e IMT-së Bashkia Tiranë, të cilët kanë prishur ndërtimin; (iii) nga ana e prokurorit në rihetimin e kësaj çështjeje duhet të kryhen veprimet e nevojshme hetimore për të verifikuar nëse këta punonjës ishin të pajisur ose jo me një urdhër pune, ku të përcaktohej qartë objekti, detyrat dhe funksionet e secilit inspektor. Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 1.11.2016, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka kryer hetime, duke marrë vendimin e mosfillimit të procedimit penal.

7.5 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

7.6 Subjekti pas kalimit të barrës së provës deklaroi se: *“Kam vendosur mosfillim për arsye se shtetasi N. M. nuk ka depozituar dokumentacion, pala tjetër ka sjellë dokumentacion si, lejen e ndërtimit, lejen e sheshit dhe të gjithë dokumentacionin e Bashkisë së Tiranës në lidhje me këtë çështje. Kam vendosur bazuar në bindjen time dhe me sa di edhe me pas prokurori që ma ka zëvendësuar ka kërkuar pushimin e hetimeve. Sqaroj se para se të vendosej mosfillimi i procedimit penal është paraqitur për kallëzuesin avokati i tij, të cilit i kam kërkuar dokumente shtesë për kallëzimin e tij, pasi kishte vetëm dy dokumente, lejen e legalizimit dhe një plan rilevimi, ndërsa nga pala tjetër kishte një sërë dokumentacioni si, leje ndërtimi, planvendosje të truallit të ndërtimit, kontrata, certifikata pronësie të pronarëve. Gjatë verifikimit të materialit bazuar në pretendimet e shtetasit M. M. për veprimet e punonjësve të IMT-së ndaj rrethimit të pronës së tij, i është kërkuar Bashkisë Tiranë për lejen e ndërtimit që dispononte subjekti ndërtues dhe veprimet e kryera nga punonjës të IMT-së në datën 26.10.2016. Nga Bashkia Tiranë është konfirmuar me shkresën nr. ***, datë 30.11.2016, se subjekti ndërtues kishte kërkuar në datën 23.9.2016 ndërhyrjen e IMT-së për lirim të sheshit të ndërtimit, referuar vendimit të Bashkisë nr. ***, datë 20.8.2016 dhe IMT mbi bazën e kësaj kërkesë ka kryer lirim të sheshit të ndërtimit bazuar në lejen e ndërtimit të dhënë për këtë subjekt. Njëkohësisht, punonjësit e IMT-së ishin të mbështetur edhe nga policia e shtetit në veprimet e tyre. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata Apelit Tiranë. Unë e kam rimarrë çështjen për të rihetuar, por në këtë kohë shtetasi M. M. ka kërkuar që çështja të hetohet nga një prokuror tjetër dhe për këtë kërkesë kam njoftuar drejtuesin e Prokurorisë, duke vlerësuar si të rëndësishëm besimin dhe paanshmërinë në sytë e palëve, ku i kam kërkuar drejtuesit që çështjen ta hetonte një prokuror tjetër. Nga drejtuesi është urdhëruar që hetimet të vazhdonin nga ana ime. Në datën 28.3.2019 i jam drejtuar sërish drejtuesit të Prokurorisë, pasi shtetasi M. M., nuk ishte dakord që unë të hetoja dhe drejtuesi i Prokurorisë, me vendimin e datës 2.4.2019, e ka pranuar dorëheqjen time. Nëse kam gabuar në gjykimin tim fillestar, për shkak se nuk i kam pasur provat e plota ose jam nxituar e nuk kam kërkuar më shumë prova para se të arrija në këtë vendimmarrje për shkak të ngarkesës, problematikave të ditës dhe gjykata ka vlerësuar vazhdimin e hetimeve, ka qenë detyrimi im të reflektoj dhe të vazhdoj me objektivitet deri në fund”*.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.7 Nga dokumentacioni i administruar në lidhje me këtë procedim, edhe pas shpjegimeve të subjektit u konstatua se nuk ishin kryer hetime të thelluara dhe subjekti kishte vendosur mosfillim hetimi edhe për shkak se denoncuesi M. M. nuk kishte paraqitur dokumentacion për të provuar se kishte fituar titullin e pronësisë me legalizim. Pas rikthimit të çështjes për t'u hetuar sipas detyrave të lënë nga gjykata, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka konstatuar se inspektorët e IMT Tiranë nuk kanë konsumuar elemente të veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

7.7.1 Përfundimisht, duke qenë se fakti nuk përbën veprë penale, bazuar në nenin 329/a dhe nenin 328, pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria kërkon pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

7.8 Sa më sipër, Komisioni arriti në konkluzionin se nuk provohej që nga ana e inspektorëve të IMT-së, Bashkia Tiranë, të ishin konsumuar elemente të veprës penale “shpërdorim detyre” dhe gjithashtu edhe hetimet e mëtejshme nga një prokuror tjetër kishin përfunduar me kërkesë drejtuar gjykatës për pushimin e procedimit.

Konkluzioni i Komisionit për kontrollin e figurës

8. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

8.1 Komisioni, lidhur me kriterin e figurës, nuk konstatoi *indicie* apo informacione, sipas kërkesave të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, që mund të përbënin dyshim të arsyeshëm gjatë kryerjes së hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit.

8.2 Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Julian Zonja ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

9. Vlerësimi profesional është kryer për subjektin e rivlerësimit nga institucioni ndihmës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky vlerësim është kryer mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

9.1 Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri dokumenteve të paraqitura nga vetë subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura bazuar në sistemin rastësor, si vijon:

C/1. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

10. Dokumenti ligjor – konkluzione përfundimtare në gjykimin e çështjes penale nr. ***, viti 2014, me të pandehur O. X., akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, më shumë se një herë, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

10.1 Dokumenti ligjor – kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2012, me të pandehur A. Xh. etj., akuzuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim i vulave, stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal. Nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

10.2 Dokumenti ligjor – apelim kundër vendimit gjyqësor penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 12.4.2016. Kërkohej ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 12.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e deklaruar fajtor dhe dënuar të pandehurin për veprën penale “vrasje me paramendim”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 78/1-22 i Kodit Penal. Nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

ANALIZA E GJETJEVE

11. Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit Julian Zonja shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

11.1 Subjekti ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë, përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre.

11.2 Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Julian Zonja, për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

11.3 Subjekti i rivlerësimit Julian Zonja shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Nga të dhënat statistikore rezulton se prokurori Julian Zonja, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 627 materiale.

11.4 Subjekti i rivlerësimit Julian Zonja ka ushtruar kompetencat që ligji i njej prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes të policisë gjyqësore.

11.5 Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ndjekje penale në një sërë materialesh hetimore. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Subjekti i rivlerësimit ka përballuar ngarkesën në punë me efikasitet.

11.6 Subjekti i rivlerësimit merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

11.7 Konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe disponimin e Gjykatës.

11.8 Rezulton nga dosjet e shqyrtuara se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

11.9 Konstatohet se për subjektin e rivlerësimit Julian Zonja nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Julian Zonja.

8.13 Nga dokumentacioni i administruar vihet re (tri dosje të zgjedhura prej tij dhe pesë sipas shortit) se nga ana e subjektit të rivlerësimit komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit.

8.14 Subjekti i rivlerësimit Julian Zonja rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale

9. Trupi gjykues, bazuar në: (i) konstatimet dhe argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit; (ii) gjetjet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” – arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Julian Zonja ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

DENONCIME

10. Pranë Komisionit janë regjistruar 8 denoncime, të cilat janë administruar dhe analizuar dhe ka rezultuar se 6 prej tyre nuk përmbanin *indicie* për shkelje të ligjit nga ana e subjektit të rivlerësimit, ndërsa për 2 të tjera Komisioni vlerësoi t’i kërkojë subjektit të japë shpjegime, si vijon:

10.1 Denoncim nr. *, datë 29.7.2019, i shtetasit S. M.**, drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Nga administrimi i këtyre denoncimeve, denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit për korrupsion, moshetim të çështjes, zvarritje etj. Në denoncimet e tij denoncon jo vetëm subjektin, por edhe një sërë zyrtarësh të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, disa prokurorë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, drejtues dhe inspektorë të Policisë së Qarkut Fier, gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë etj. Komisioni ka hetuar në lidhje me këtë denoncim dhe në përgjigje të kërkesës ka administruar fashikujt penalë, nga të cilët rezulton se:

- Në datën 4.10.2007, në rrugën nacionale *** është përplasur një automjet me drejtues të miturin O. D. dhe motoçikleta me drejtues shtetasin B. C., nga Elbasani. Nga përplasia e këtyre mjeteve është plagosur rëndë shtetasi B. C., i cili është shtruar në spital dhe pas ndërhyrjes që i ka bërë mjeku S. M. ka shpëtuar. Në datën e aksidentit, 4.10.2007, në spitalin e Fierit, vëllai i të miturit O. D., shtetasi S. D., ka takuar mjekun S. M., i cili pretendon se kishte përdorur për operacion mjete të shtrenjta ortopedike, që kushtonin dhe se ishin të tijat personale dhe jo të spitalit. Shtetasi S. D. kishte marrë përsipër pagimin e detyrimit për kurimin e shtetasit B. C. Mjeku pretendonte se shpenzimet ishin në shumën 1.100 euro. Ditën e operacionit i kishte paguar doktorit S. M. shumën 500 euro dhe pjesën tjetër do t’ia jepte në një moment të dytë. Në datën 19.10.2010 shkon të takojë mjekun, me arsyen e pagimit të pjesës tjetër të parave dhe aty e arreston atë, me akuzën e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “korrupsion aktiv i funksionarëve që ushtrojnë detyra publike”.

Në bisedimet përfundimtare prokurori ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit S. M., për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet e 6 muaj burgim dhe 600.000 lekë gjobë. Në aplikim të nenit 20, pika 1 dhe nenit 35 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 2 vjetësh.

Në vendimin e datës 2.5.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendosi “Deklarimin fajtor të të pandehurit S. M. dhe dënimin e tij me 2 vjet e 6 muaj burgim dhe 500.000 lekë gjobë”. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, për pjesën e pavuajtur të dënimit prej 1 viti e 8 muaj e 10 ditë, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit për një periudhë prej 2-vjetësh, me kusht që gjatë kësaj periudhe prove i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale kaq të rëndë apo më të rëndë se kjo.

Për sa më sipër, lidhur me procedimin penal, Komisioni konstaton: *Mungesë hetimesh ndaj personit i cili i afroji shumë e parave të pandehurit, duke mos kryer veprime hetimore në lidhje me veprën penale “korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal.*

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i ka kaluar barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.1.1 Subjekti, pas kalim të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se: *“...Nga aktet rezultoi se nga momenti i parë që shtetasi S. D. ka shkuar në spital për t’u interesuar për shëndetin e të aksidentuarit dhe sipas kallëzimit të tij për të përballuar ai shpenzimet e spitalit, doktori i ka thënë kallëzuesit se operacioni bënte 1.200 euro dhe i është drejtuar kallëzuesit duke i kërkuar 1.100 euro. Kjo ka ndodhur në prani edhe të familjarëve të të dëmtuarit, ku kallëzuesi ka gjetur 500 euro atë ditë dhe ia ka dhënë doktorit. Ndërsa në momentin e dytë në datën 19.10.2007 ai ka bërë kallëzim, pasi siç rezultoi nga deklaratimet e të dëmtuarit dhe nënës së tij, të cilët kanë qenë ata që kanë njoftuar kallëzuesin se nuk mund të dilnin nga spitali, pasi doktori kërkonte dhe pjesën tjetër të lekëve, duke ju thënë se “nuk do të dilte nga spitali pa i dhënë hakun e punës”. Vetë kallëzuesi ka thënë se u detyrua t’i paguante lekët e para, pasi i kishte thënë të dëmtuarit se do t’i paguante ai shpenzimet e spitalit. Ky është një rast me veprime simuluese.*

*Procedimi penal nr. ***, viti 2007, ka filluar me kallëzimin e shtetasit S. D., i cili ka pranuar të bashkëpunojë për të kryer veprim simulues me policinë gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku më pas ka bërë kallëzim dhe po atë ditë janë autorizuar veprime simuluese nga prokurori. Në këto kushte është e qartë se kallëzuesi nuk mund të merret në përgjegjësi për veprën penale të korrupsionit aktiv, duke vepruar me autorizim të prokurorit për të kryer një veprim hetimor, sipas nenit 294/a të Kodit të Procedurës Penale, në marrëveshje dhe bashkëpunim me policinë, simulim të një akti korruptiv, i cili është vlerësuar nga gjykata.*

Pra, një person që autorizohet nga prokurori për veprim simulues nuk mund të akuzohet për korrupsion aktiv sipas nenit 244 të Kodit Penal, pasi nuk po vepron me vullnetin e tij, i lirë dhe me dashje për të kryer një nga veprimet që parashikon kjo dispozitë, jashtë kontrollit të organit procedues, siç e kam shpjeguar edhe më sipër. Këto veprime hetimore me autorizim të prokurorit, kallëzuesi i ka bërë me oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Të gjitha këto rrethana gjykata i ka vleftësuar të ligjshme dhe ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”, të cilat janë arsyetuar po kështu edhe në vendimin përfundimtar. Nga ana ime si prokuror është dëgjuar personi i arrestuar, është zbatuar detyrimi për të pyetur si të arrestuar në flagrancë shtetasin S. M. në procesverbalin e të arrestuarit në flagrancë dhe, ashtu si edhe gjatë procedimit që është pyetur përsëri, ai nuk ka

shprehur ndonjë pretendim kundër prokurorit, duke u shprehur vetëm “se nuk është dakord me shpifjet dhe kurthin e sajuar nga kallëzuesi”.

Referuar vendimit të gjykatës, nuk jemi para formës së dhënies që parashikonte neni 244 i Kodit Penal të kohës, por para formës së kërkimit nga i pandehuri. Konkretisht, gjykata është shprehur “pikërisht për arsyet e mësipërme i pandehuri, pavarësisht nga vlera e materialeve e pajisjeve që ka përdorur, nuk duhet të kërkonte dhe më vonë edhe të merrte shpërblim për operacionin që kreu ndaj shtetasit B. C.”.

Në përfundim, nisur nga faktet e parashtruara, të kishte mungesë hetimi sipas përcaktimeve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, të cilat nuk do të ishin neglizhuar nga ana ime. Kjo çështje është regjistruar në datën 19.10.2007 dhe është dërguar për gjykim në datën 8.11.2007, rreth 20 ditë dhe gjykimi ka përfunduar në datën 29.4.2008, për një kohë të shpejtë, rreth 5 muaj, ku ka pasur disa dëshmitarë, kryesisht nga ana e të pandehurit. Ka qenë një nga dosjet e para të korrupsionit në Prokurorinë e Fierit, që është realizuar me veprime proaktive, veprime të cilat pothuajse nuk njiheshin dhe nuk aplikoheshin në atë kohë”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.1.2 Komisioni, pasi administroi dhe analizoi dokumentacionin e sjellë nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe e dëgjoi atë në seancë dëgjimore, vëren se subjekti në lidhje me këtë procedim penal ka kryer veprimet hetimore si: urdhër për regjistrimin e procedimit penal datë 19.10.2007, procesverbal për kallëzimin e veprës penale, autorizim për kryerjen e veprimit simulues datë 19.10.2007; procesverbal mbi përdorimin e një sasive prej 600 euro për veprime simuluese, vendim për lejimin e përgjimit datë 19.10.2007, ora 9:00, vendim për vleftësimin e përgjimit datë 21.10.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; procesverbal i këqyrjes dhe marrjes së provës materiale datë 19.10.2007, procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale; procesverbal i pyetjes së të arrestuarit në flagrancë; urdhër për delegimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore të çështjes penale nr. ***.

- Hetimet në lidhje me këtë çështje janë bërë me anë të veprimeve simuluese, prandaj nuk kemi veprë penale të korrupsionit aktiv, të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. Veprimet simuluese janë kryer me autorizim të prokurorit të çështjes. Neni 294/a i Kodit të Procedurës Penale përcakton veprimet simuluese². Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e ka gjetur të drejtë cilësimin juridik të veprës penale ndaj të pandehurit S. M. dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit S. M. dhe dënimin e tij me 2 vjet e 6 muaj burgim dhe 500.000 lekë gjobë”. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, për pjesën e pavuajtur të dënimit prej 1 viti e 8 muaj e 10 ditë urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit për një periudhë prej 2-vjetësh, me kusht që gjatë kësaj periudhe prove i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale kaq të rëndë apo me të rëndë se kjo.

² Neni 294/a i Kodit të Procedurës Penale: “1. Oficeri i policisë gjyqësore ose një person i autorizuar mund të ngarkohet për të kryer blerje ose shitje të simuluar të sendeve që janë të ndaluara për t’u prodhuar, zotëruar, mbajtur apo tregtuar, apo sende që rrjedhin nga një krim ose simulimin e një akti korruptiv, ose të kryejnë veprime të tjera simuluese, për të zbuluar dhe mbledhur prova për personat e dyshuar për kryerjen e një krimi, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e tyre si punonjës policie. 2. Këto veprime bëhen me autorizimin dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit që kontrollojnë hetimet ose të prokurorit që ka në juridiksion territorin ku do të zhvillohet veprimi. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, policia gjyqësore duhet t’i dorëzojë prokurorit të gjitha provat e mbledhura dhe një raport përmbledhës. 3. Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret”.

Komisioni, bazuar në shpjegimet e subjektit dhe në dokumentacionin e administruar dhe shqyrtuar, vlerëson se veprimet e subjektit në lidhje me këtë çështje janë në përputhje me ligjin material dhe Kodin e Procedurës Penale.

10.2 Denoncim nr. * prot., datë 27.4.2018, i shtetasit B. Xh.**, nëpërmjet të cilit ky shtetas denoncon prokurorin dhe gjyqtarin e çështjes së vdekjes së djalit të tij. Prokuroria ka kryer hetime të vonuara pas 16 muajsh dhe gjyqtari zvarriti çështjen. Komisioni, pasi studioi dokumentacionin e paraqitur nga denoncuesi, vëren se:

- Me vendimin nr. ***, datë 17.7.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit M. Xh., për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/4 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në bisedimet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar shpalljen fajtor të të pandehurit M. Xh., për veprën penale të parashikuar nga neni 290/4 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burg. Kjo çështje i referohet ngjarjes që ka ndodhur në datën 19.1.2016, rreth orës 9:30, ku shtetasi M. Xh., duke drejtuar automjetin e tij “****”, ka përplasur këmbësorët E. H. dhe E. Xh., të cilët ishin në trotuarin e stacionit të autobusit. Si pasojë e kësaj përplasjeje shtetasi E. Xh. është dërguar në gjendje kritike në spital, ku pas një ditë, me datë 20.1.2016, ka humbur jetën, ndërsa shtetasi tjetër është plagosur rëndë. Drejtuesi i mjetit, shtetasi M. Xh., është arrestuar në flagrancë dhe ndaj tij është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Më pas, organi procedural penal ka hetuar në lidhje me këtë çështje dhe nga shqyrtimi i dosjes rezulton se në lidhje me këtë veprë penale janë bërë disa akte ekspertimi nga grupe të ndryshme ekspertësh.

Komisioni vëren se kjo çështje është zvarritur, duke u kryer disa akte ekspertimi dhe në fund masa e dënimit e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit për pasojën që ka ardhur nga kjo veprë penale është afër minimale që parashikon legjislacioni penal.

Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.2.1 Në lidhje me këtë denoncim, subjekti pas kalimit të barrës së provës deklaroi se: *“Procedimi penal nr. *** është regjistruar në datën 20.1.2016, për aksidentin e ndodhur në datën 19.1.2016 dhe i është deleguar oficerit të policisë gjyqësore në Kom. Pol. Rrugore. Nga oficeri i policisë gjyqësore, në datën 30.5.2016, ka përfunduar veprimet e kryera me relacionin përkatës. Procedimi penal ka veprime të ndryshme, është tabela fotografike e këqyrjes së kufomës; tabela fotografike e vendit të ngjarjes; akti i ekspertimit biologjik për viktimën dhe të dëmtuarin, i cili ishte urdhëruar menjëherë pas ngjarjes. Fillimisht të pandehurit i është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, masë e cila është zëvendësuar pas 20 ditësh me vendimin nr. ***, datë 15.2.2016, me detyrim paraqitjeje, pasi sipas aktit të ekspertimit autoteknik të administruar në këtë kohë drejtuesi nuk kishte faj për aksidentin e shkaktuar. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankimi nga prokurori dhe në këtë seancë është pretenduar se do të kryhej riekspertim. Në datën 15.4.2016, akti i parë i ekspertimit autoteknik është shpallur i pavlefshëm nga ana e prokurorit, për shkak të parregullsive dhe po në këtë datë është urdhëruar kryerja e aktit të ri të ekspertimit autoteknik, duke caktuar një grup prej 3 ekspertësh. Edhe ky akt ekspertimi ka nxjerrë pa faj drejtuesin e automjetit. Për këtë shkak, pas grumbullimit të akteve për nevoja të këtij riekspertimi është urdhëruar kryerja e riekspertimit autoteknik, duke caktuar 5 ekspertë. Sipas aktit të datës 30.12.2016, fajtor rezultonte drejtuesi*

i automjetit për shkak të shpejtësisë. Gjatë kohës që janë kryer aktet e ekspertimit janë kryer veprime të tjera hetimore si, pyetje e personave, shtetasit A. Z. në datën 31.5.2016, po kështu është pyetur vetë i dëmtuari E. H., pasi pas ngjarjes nuk ka qenë në gjendje të japë shpjegime të plota për aksidentin dhe është pyetur pasi është përmirësuar gjendja e tij në datën 30.5.2016.

Procedimi penal është deleguar për veprimet e fundit me urdhrin e delegimit të datës 20.3.2017 dhe është kthyer me datë 3.4.2017, së bashku me relacionin përkatës nga oficeri i policisë gjyqësore. Pas ardhjes së dosjes, datë 6.4.2017, nga ana ime si prokuror është deklaruar i pavlefshëm vendimi i njoftimit të akuzës, pasi oficeri i policisë gjyqësore nuk i ka komunikuar të pandehurit aktin e akuzës të hartuar dhe firmosur nga prokurori i çështjes, por një akt akuzë tjetër të hartuar nga vetë oficeri i policisë gjyqësore, që mbante datën 31.3.2017, veprim absolutisht i pavlefshëm në bazë të nenit 128, shkronja "b" e Kodit të Procedurës Penale. Prandaj është urdhëruar të përsëritet ky veprim dhe veprimet procedurale të përfundimit të çështjes.

Zvarritja e çështjes ka qenë edhe për shkak të mosmarrjes së njoftimit të akuzës nga ana e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Gjatë gjykimit gjykata i ka vlerësuar të vlefshme veprimet e prokurorit dhe zgjatjen e afateve të hetimit, pas pretendimeve të mbrojtësit të të pandehurit. Vlerësoj se ka një kohëzgjatje të hetimeve, por kurrsesi për shkaqe subjektive, gjithsesi brenda afateve të arsyeshme 2-vjeçare të hetimit dhe përveçse vetëm për arsyet e përmendura dhe ato të konstatuara nga Komisioni si, kryerja e disa akteve të ekspertimit e të tjera shkaqe të padukshme si, ngarkesës e dinamikave të tjera të çështjes ose të punës së përditshme të prokurorit, kërkesave të palëve, etj.

Për sa i përket masës së dënimit nga ana ime si prokuror në këtë çështje, është kërkuar 7 vjet burgim, ku dispozita e nenit 290/4 të Kodit Penal, për të cilin është akuzuar i pandehuri, parashikon nga minimumi 5 vjet burgim deri në 20 vjet burgim. Nga ana objektive e veprës penale, që të jetë e plotësuar plotësisht, kërkon si pasojë dy ose më shumë vdekje apo dy apo më shumë plagosje të rënda, në kuptimin që ajo të marrë rrezikshmëri të lartë dhe në përputhje me rrezikshmërinë për këto lloj pasojash të jepet edhe një masë më e lartë dënimi, ndërsa në këtë rast jemi përpara diçkaje të ndërmjetme (1 vdekje dhe 1 plagosje e rëndë). Masat e larta të dënimit që parashikon dispozita deri në 20 vjet burgim, vlerësoj se janë për ngjarje me pasoja tepër të rënda, si p.sh. disa vdekje ose plagosje të rënda, të shoqëruara edhe me rrethana të tjera. Në rastin konkret, nuk ka pasur disa vdekje dhe disa plagosje të rënda, por vetëm një vdekje e një plagosje të rëndë, e vepra është kualifikuar në paragrafin 4 të nenit 290 të Kodit Penal. Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat dhe personalitetit të të pandehurit, faktin e normalizimit të marrëdhënieve si rrethanë lehtësuese me të plagosurin E. H., në bindjen time kam vlerësuar se 7 vjet burgim është një masë dënimi proporcionale me këto rrethana të çështjes, ndërsa në bindjen e gjykatës i pandehuri është dënuar me 5 vjet burgim, pra me minimumin e dispozitës”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.2.2 Bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe në atë të përcjellë nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, si dhe në shpjegimet e tij në seancë dëgjimore, Komisioni konstatoi se çështja e hetuar nga subjekti i rivlerësimit ishte komplekse. Kjo çështje në fazën e hetimeve ishte zvarritur, por këto zvarritje nuk ishin për faj të veprimeve të subjektit, pasi ishin kryer disa akte ekspertimi teknik që kishin të bënin me përcaktimin e shpejtësisë së mjetit në momentin e aksidentit. Në të dyja aktet e para të ekspertimit rezultonte se drejtuesi i

mjetit nuk ishte me shpejtësi, ndërsa në aktin e tretë vërtetohet fakti se drejtuesi i mjetit ishte me shpejtësi tej normave të lejuara. Shkak tjetër për zvarritje ishin edhe arsye të tjera si, njoftimet e të pandehurit dhe mbrojtjes.

Sa i takon masës së dënimit, interpretimi i normës penale nga subjekti i rivlerësimit është bindës dhe qëndron brenda masës së parashikuar nga norma penale.

Trupi gjykues i Komisionit, bazuar në provat e administruara të dosjes penale, vlerëson se veprimet e subjektit janë në përputhje me ligjin material dhe procedural penal.

10.3 Lidhur me procedimin penal nr. *, viti 2016**, për të cilin u riçel hetimi administrativ nga ana e Komisionit dhe u tërhoq procedimi penal pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga aktet procedurale u konstatua se në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykim, datë 3.2.2017, të përpiluar nga subjekti i rivlerësimit, nga rrethanat dhe faktet rezultoi se:

- Në datën 7.8.2016, policia gjyqësore ka njoftuar se në landfillin e *** ishte gjetur një kufomë në grumbullimin e mbeturinave të sheshit të riciklimit, ku pas identifikimit rezultoi të ishte shtetasi A. Gj., i datëlindjes 11.7.1999 (17 vjeç). Shtetasi A. Gj. punonte në landfillin e *** prej afërsisht 1 muaji dhe vetëm turni i tretë, aty ku subjekti “****” sh.p.k. ushtron aktivitetin e përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve urbane, bazuar në një akt marrëveshjeje me ***. Edhe në momentin e gjetjes së kufomës ai ishte i veshur me uniformën e punëtorit të kësaj firme, me kominoshe ngjyrë gri dhe doreza të gomuar pune.

Në këqyrjen e vendit të ngjarjes konstatohet se zyrat e shoqërisë “****” sh.p.k., në ambientet e landfillit të *** është e përshtatur në një kontejner, ku në këtë zyrë janë sekuestruar fletë të ndryshme me emra e mbiemra të punëtorëve sipas turneve, ku aty figuron i shënuar edhe emri i shtetasit A. Gj. deri ditën e ngjarjes. Ditën e ngjarjes shtetasi A. Gj. ka ardhur rregullisht në punë, e provuar kjo nga thëniet e dëshmitarëve dhe nga vetë i pandehuri D. H., me detyrë përgjegjës turni i tretë, nga dëshmitarë të tjerë në vendngjarje, nga familjaret e tij, nga uniforma që kishte veshur dhe nga veshjet e tij të shtëpisë apo biçikleta me të cilën kishte ardhur në punë, të palëvizuar nga vendi i punës.

Në landfill janë kryer këqyrje të ndryshme për të zbuluar gjurmë dhe prova materiale të veprës penale si, këqyrja e vendit të gjetjes së kufomës, këqyrja e mjetit tip fadromë me ngjyrë të verdhë, që drejtohej atë ditë nga i pandehuri E. K.. Ky mjet rezultoi pa targa dhe lëviz me anë të zinxhirëve. Që në fillim ky mjet u dyshua si mjeti që kishte dëmtuar shtetasin A. Gj., duke parë se nga këqyrja e kufomës në vendin e ngjarjes nga ekspertët kriminalistë dhe mjekoligjorë rezultoi dëmtime të mëdha të shkaktuara nga mjete të tonazhit të rëndë. Për këtë arsye, kjo fadromë është këqyruar me imtësi dhe janë marrë kampione të njollave të kuqe që ndodheshin në zinxhirët e saj, por nga akti i ekspertimit nuk u arrit të përfytohej asnjë profil gjenetik me vlera identifikuese.

Trupi i shtetasit A. Gj. kishte dëmtime të mëdha, të cilat janë shkaktuar nga mjet i fortë mprehës me mekanizmin e goditjes. Shkaku i vdekjes ka qenë dëmtime masive politraumatike të trupit me mekanizmin e shokut të rëndë traumatiko-hemorragjik.

I pandehuri D. H. ka kryer detyrën e përgjegjës të punës për punonjësit e turnit të tretë, kur punonte edhe shtetasi A. Gj., si rrjedhim ishte detyrë e këtij të pandehuri të siguronte nga punonjësit zbatimin e rregullave që kanë të bëjnë me punën dhe sigurimin në punë. Nga ky i pandehur dhe në përgjithësi në landfill nuk janë ndërmarrë veprime për të evituar ngjarje të

tilla si, udhëzime kolektive apo individuale të punonjësve për mbrojtjen e tyre, aq më tepër në kushtet e natës. I padituri D. H. pretendoi se ngjarja mund të ketë ndodhur jashtë landfillit dhe më pas e kanë sjellë aty, pretendim që rezultoi i pavërtetë nga deklarimi i shtetasës Z. B. apo nga këqyrjet e vendit të ngjarjes, si dhe gjetja dhe pyetja e punëtorëve të kamionëve që kanë shkuar në landfill atë natë. Në kundërshtim me vetëdeklarimet e tij vjen edhe fakti se ishte ai që i tha viktimës ku duhet të punonte rreth orës 3:30, kur ai mbërriti në punë me shtetasen Z. B. dhe me faktin që deklaroi përgjegjësi i turnit të parë E. M. se D. i tha që A. kishte qenë në punë, apo edhe me faktin se në praktikën me emra e mbiemra sipas turneve të gjetura në zyrat e shoqërisë, figuron i shënuar edhe emri i shtetasit A. Gj. dhe konkretisht nga i pandehuri, pasi shtetasi A. Gj. ka punuar vetëm në turnin e tretë, ku detyrën e përgjegjësit e ushtronte i pandehuri D. H.

Në bisedimet përfundimtare të kësaj çështjeje, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar 9 vjet burg për të pandehurin D. H., 6 vjet burgim për të pandehurin E. K., për veprën penale “shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë” dhe 1 vit burgim për veprën penale “drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt”. Në bashkim të dënimeve, dënimin me 6 vite e 6 muaj burgim për të pandehurin E. K.

Në fashikujt e këtij procedimi penal ndodhen një sërë aktesh procedurale, të tilla si: akt ekspertimi biologjik; akt ekspertimi teknik telefoni; foto të objektit; pamje filmike të vendngjarjes; vendim për zgjatjen e afatit; urdhër për procedimin penal; urdhër për delegim veprimesh, vendim pushimi, kërkesë për dërgimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2016 në gjykatë; procesverbale të marrjes së të dhënave nga personat që kanë dijeni për veprën penale. Janë pyetur punëmarrësit e turnit të tretë dhe turnit të parë që punonin në Landfillin e ***.

Procesverbal i arrestimit në flagrancë, datë 7.8.2016, ora 23:30, e shtetasit D. H., për veprën penale “shkelje të rregullave të sigurimit në punë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 289/2 i Kodit Penal; kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit D. H., datë 8.8.2016, me detyrë përgjegjës turni; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 10.8.2016, për vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj personit nën hetim D. H., caktimin si masë sigurimi “arrest në burg”.

Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, për lënien në fuqi të vendimeve për vleftësimin e masës së sigurimit; vendim nr. ***, datë 7.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për rrëzimin e kërkesës së personit nën hetim D. H., për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi”, me arsye se është i sëmurë.

Organi i akuzës në qëndrimin e tij, i përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës së personit nën hetim. Procesverbal i arrestimit datë 8.8.2016, ora 1:00 në flagrancë të shtetasit E. K. me detyrë drejtues i fadromës, për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal “shkelje të rregullave të sigurimit në punë” dhe veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal.

Kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit E. K., datë 8.8.2016, me detyrë drejtues i fadromës në Landfillin e ***, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/2 i Kodit Penal; vendim nr. *** akti, datë 10.8.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj personit nën hetim E. K., caktimin si

masë sigurimi “arrest në burg”; vendim për njoftimin e akuzës dhe marrjen e personit të pandehur, datë 23.1.2017, ndaj shtetasit E. K.

Në datën 8.11.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor të procedimit penal nr. *** të vitit 2016, deri në datën 8.2.2017, të njoftojë për këtë vendim të pandehurin, të dëmtuarin i cili ka të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi. Arsyetimi për marrjen e këtij vendimi është bazuar në kryerjen e domosdoshme të veprimeve të tjera hetimore, duke zgjatur afatin, kjo për shkak të kompleksitetit të ngjarjes dhe mekanizmit të saj. Në këto kushte, kur janë kryer një sërë veprimesh hetimore, ndërsa për rrethana objektive nuk mund të përfundoheshin hetimet brenda afatit tremujor, është e nevojshme zgjatja e afatit hetimor të këtij procedimi penal.

Janë sekuestruar nga ana e organit procedues materialet e sendeve të ndodhura në landfillin e ***, fletore turni dhe prova të tjera të gjetura në vendngjarje. Nga ana e subjektit është përpiluar lista e personave që do të thirren në gjykim si dëshmitarë. Pyetje të ekspertëve mjekoligjorë dhe atyre teknikë të përgatitura nga subjekti i rivlerësimit.

Me vendimin e datës 17.4.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit D. H., për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, si dhe deklarimin e pafajshëm të të pandehurit E. K. për të njëjtën veprë penale”.

Në fashikujt e hetimit gjendet gjithashtu edhe shkresa me nr. *** prot., datë 30.4.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet së cilës dërgohet ankimi i prokurorit ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 17.4.2018. Ankimi është përpiluar nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me konstatimet e gjykatës se nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore për zbardhjen e ngjarjes, që i përket procedimit penal nr. *** dhe nëse kjo çështje është gjykuar në Gjykatën e Apelit. Gjithashtu i ka kërkuar të japë sqarime nëse ka kryer veprime hetimore në lidhje me procedimin penal të ndarë më vete dhe, nëse po, të vërë në dispozicion dosjen e procedimit penal në ngarkim të administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., shtetasit E. T. dhe me ecurinë e kësaj çështjeje, duke paraqitur vendimin e gjykatës nëse çështja ka kaluar për gjykim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.3.1 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti deklaroi se: *“Çështja është ende duke u gjykuar në Gjykatën e Apelit. Unë i qëndroj bindjes time dhe vlerësimeve të mia që kam bërë që në atë kohë. Nuk mund të shprehem mbi një vendim gjykate që ende nuk është certifikuar nga gjykatat më lart. I qëndroj vlerësimit tim në lidhje me ngjarjen që kam bërë në konkluzionet përfundimtare dhe në ankim dhe nga ana tjetër nuk dua të gjykoj mbi vendimmarrjen e gjykatës. Ka pasur pretendime për vendin e ngjarjes, sidomos nga të pandehurit, për mua vendi i ngjarjes është aty, mjaftuar vetëm nga një fakt i thjeshtë, siç e kam thënë që viktimja ka qenë me doreza në duar, pra ka qenë në punë brenda landfillit. Pavarësisht si do të shkonte gjykimi, kam menduar që më e mira do të ishte një procedim i ndarë që nëse dikush mund të fliste, të dilte një prove e re, procedim i cili më pas është pezulluar sepse varej nga vendimi i Gjykatës së Apelit nëse do vendoste fajësi apo lënie në fuqi. Çdo procedurë do varej nga ky vendim, pasi gjykata e shkallës së parë vuri në dyshim vendin e ngjarjes. Pra, nëse ngjarja do të jetë jashtë, shmanget çdo përgjegjësi e subjektit që punonte aty. Nëse Gjykata e Apelit do të vendosë që*

ngjarja ka ndodhur në landfill, në një fazë të mëvonshme të përfshija edhe subjektin tregtar që punonte aty”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.3.2 Komisioni, pasi administroi dokumentacionin e procedimit penal nr. ***, viti ***, si dhe dëgjoi subjektin në shpjegimet e tij në seancë dëgjimore, konstatoi se nga ana e subjektit të rivlerësimit janë kryer veprimet procedurale në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Nga ana e subjektit është vendosur zgjatja e afatit të hetimeve edhe me 3 muaj, për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe veprimeve hetimore të shumta dhe akteve të ekspertimit të sipërcituara. Brenda gjashtë muajve nga ngjarja, subjekti ka paraqitur kërkesë për gjykimin e çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës, subjekti ka analizuar e shoqëruar me prova fajësinë e dy të pandehurve, duke i akuzuar për kryerjen e veprës penale “shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë dhe drejtim të mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga nenet 289 dhe 291 të Kodit Penal.

Nisur nga veprimet e kryera hetimore, parë në dritën e përcaktimeve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, kjo çështje është regjistruar në datën 7.8.2016 dhe është dërguar për gjykim në datën 3.2.2017, për një kohë prej rreth 6 muajsh, ku ka pasur disa akte ekspertimi, pyetje dëshmitarësh dhe veprime të tjera procedurale. Megjithëse ky procedim ka qenë shumë kompleks, subjekti ka treguar përkushtim në drejtim të hetimit, aftësi për të mbledhur prova, për t’i interpretuar ato në raport me ligjin.

Trupi gjykues i Komisionit nuk vërejti ndonjë *indicie* për shkelje të ligjit nga ana e subjektit në lidhje me hetimin e kësaj çështjeje.

Qëndrimi i Komisionit mbi denoncimet

10.4 Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme, sipas ligjit nr. 84/2016, si dhe shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elemente që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e prokurorit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Julian Zonja:

- a) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në bazë të nenit 51, shkronja “a”, pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Julian Zonja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.6.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Xhensila PINE
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana